

Në bazë të nenit 47 të Statutit të Partisë ALTERNATIVA, Kryesia Qendrore e Partisë ALTERNATIVA, në mbledhjen e mbajtur në Shkup, më 20.12.2024 e propozon dokumentin:

KODI ETIK
I FUNKSIONARËVE PARTIAKË DHE SHTETËRORË TË PARTISË ALTERNATIVA



Preambula

Funksionarët¹ e Partisë ALTERNATIVA përballen çdo ditë me vendime, të cilat, përveç aspektit ligjor, kanë edhe implikime etike e morale, si edhe kanë të bëjnë me çështje që kanë një interes të lartë publik. Publiku kërkon vendimmarrje të ligjshme, shërbim cilësor dhe të hapur. Për rivendosjen e besimit të funksionari, nëpërmjet rikthimit të besimit publik në integritetin e tij, është hartuar ky Kod Etik, i cili është konceptuar si mjet për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të qëndrimeve dhe sjelljeve drejt standardeve më të larta të drejtimit dhe moralitetit në sferën e çështjeve përkatëse.

Duke qenë koshientë për një sistem etik që Partia ALTERNATIVA tashmë e ka instaluar, në mënyrë të pashkruar, në jetën publike dhe politike, që shprehet në mënyrën e komunikimit me publikun dhe me palët e ndryshme, por edhe në mënyrën e veshjes, pamjes së jashtme dhe standardeve të moralit autokton, funksionari i Partisë ALTERNATIVA është i detyruar t'i përmbahet këtij sistemi etik.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kodi Etik ka për qëllim të përcaktojë rregullat e etikës, që do të garantojnë një sjellje të përgjegjshme të funksionarit të Partisë ALTERNATIVA në ushtrimin e funksionit të tij, kjo në përputhje me interesin e ligjshëm publik dhe me programin e Partisë.

Kodi gjithashtu synon të forcojë ndjenjën e përgjegjësisë individuale dhe kolektive të funksionarëve, duke i orientuar ata drejt vendimmarrjeve që mbrojnë interesin publik dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimeve. Ky dokument shërben si një instrument që jo vetëm rregullon sjelljen e funksionarëve, por edhe promovon transparencën, etikën dhe llogaridhënien si parime themelore të Partisë ALTERNATIVA.

Neni 2

Fusha e veprimit

Rregullat etike të përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë funksionarët e Partisë ALTERNATIVA, pavarësisht nivelit të tyre hierarkik apo fushës së veprimit. Zbatimi i këtyre rregullave garanton respektimin e vlerave të partisë, ruajtjen e integritetit institucional dhe ndërtimin e besimit të publikut ndaj funksionarëve dhe veprimtarisë së tyre.

Neni 3

Parime të përgjithshme

- 1. Parimi i ligjshmërisë.** Funksionari i Partisë ALTERNATIVA duhet t'i zbatojë normat juridike të shtetit, si dhe Statutin dhe Programin e Partisë ALTERNATIVA.

¹ Me funksionarë nënkuptohen të gjithë personat e zgjedhur/emëruar nga populli, Parlamenti, Qeveria, ministrët përkatëse ose nga ndonjë organ tjetër, si dhe funksionarët partiakë (kryetar, nënkryetarë, sekretarë etj.), që janë zgjedhur në detyra publike (me zgjedhje popullore ose mënyra të tjera të zgjedhjes) me mandat të caktuar.

2. **Parimi i besueshmërisë dhe solidaritetit.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA duhet t'i respektojë vendimet e miratuara në mbledhjen e organet e Partisë ALTERNATIVA dhe të ofrojë mbështetjen e tij në publik për të gjitha vendimet e marra, pavarësisht nëse ai ka marrë pjesë ose jo në mbledhje ose nëse ka votuar "pro" ose "kundër" atij akti.
3. **Parimi i mosdiskriminimit.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA, gjatë ushtrimit të funksionit, me veprimet ose mosveprimet e tij, nuk duhet të favorizojë ose të diskriminonjë një subjekt të caktuar për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, bindjes politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për ndonjë shkak tjetër të ngjashëm.
4. **Mosabuzimi me funksionin.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA e ushtron funksionin dhe kompetencat e tij vetëm për qëllimin që ato i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi. Ai duhet të shmangë përdorimin e funksionit të tij për qëllime, të cilat nuk kanë bazë ligjore, që janë në kundërshtim me interesat e partisë ose që nuk janë të motivuara nga ndonjë interes publik.
5. **Paanshmëria, ndershmëria dhe pavarësia.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA, në ushtrimin e funksionit të tij, duhet të jetë i paanshëm, i drejtë, i arsyeshëm dhe i pavarur. Ai duhet të shmangë çdo veprim ose trajtim preferencial, si dhe të jetë i pandikuar nga çdo interes tjetër, personal, politik, familjar dhe shoqëror.
6. **Objektiviteti.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, duhet të marrë në konsideratë faktorët përkatës dhe t'ia japë secilit prej tyre peshën e duhur në qëndrimin përfundimtar, duke përjashtuar çdo element që nuk i përgjigjet procesit konkret të punës.
7. **Transparenca dhe llogaridhënia.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA, nëse e kërkon interesi publik dhe interesat e partisë, informon dhe përgjigjet për gjithë veprimtarinë e tij si funksionar publik.
8. **Konflikti i interesit.** Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA duhet të parandalojë, si dhe t'i marrë të gjitha masat për ndërprerjen e gjendjes së konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave të tij private.
9. **Parimi i Përgjegjshmërisë**
 Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA duhet të pranojë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e tij. Ai është i detyruar të njohë dhe të adresojë gabimet e bëra, duke marrë masa për të përmirësuar situatat që mund të kenë ndikuar negativisht.

Neni 4

Sjellja e funksionarit ndaj personelit që drejton.

Funksionari i Partisë ALTERNATIVA, në marrëdhënie me personelin që drejton, duhet që:

- a) të jetë shembull i mirësjelljes si dhe t'u përmbahet me rregullshmëri, përveç legjislacionit, edhe këtij Kodi, edhe kodeve/rregulloreve të etikës, të veshjes dhe të sjelljes, që janë në fuqi në çdo institucion përkatës;
- b) ta respektojë personalitetin dhe mendimet e tyre, por edhe të nxitë bashkëpunimin e ndërsjellë;
- c) të vlerësojë në mënyrë të barabartë, objektive dhe efikase sjelljen e secilit prej anëtarëve të personelit;
- d) t'i mbrojë të drejtat e personelit dhe në asnjë mënyrë të mos i kufizojë ato;
- e) t'i ofrojë personelit mundësi të barabarta të ngritjes profesionale dhe motivim për ngritjen e efektivitetit në punë.

Neni 5

Veprimet e ndaluara

Funksionarit të Partisë ALTERNATIVA, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, i ndalohet:

- a) të kërkojë ose të pranojë shpërblim ose premtim shpërblimi lidhur me vendime të marra gjatë ushtrimit të funksionit;
- b) të fitojë ndonjë të drejtë ose të pranojë premtim për fitimin e saj, në rastet kur shkelet parimi i mosdiskriminimit;
- c) të keqpërdorë autorizimet/delegimet të cilat rrjedhin nga ushtrimi i funksionit të tij publik;
- d) të ushtrojë çfarëdo abuzimi seksual ose çfarëdo veprimi që asocon në abuzim ose ngacmim të tillë, qoftë kjo edhe kjo fjali që nënkuptojnë një abuzim ose ngacmim të tillë;
- e) të kërkojë, të përvetësojë, të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, mjete financiare, dhurata, sende me vlerë ose shërbime, në kompensim të votës së tij në vendimmarrjen kolegjiale ose në vendimmarrjen e tij individuale;
- f) të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari ose organi për arsye të përfitimit material personal, të familjarëve të tij ose të personave të lidhur me ta;
- g) të premtojë/realizojë punësim ose ndonjë të drejtë tjetër, në këmbim për dhuratë ose premtim dhurate a shërbimi
- h) të ndikojë në dhënien e shërbimeve, pasurive ose të mjeteve të fondeve publike për palën e tretë, ndërsa kjo të jetë për interesa të tij personale;
- i) të shfrytëzojë për interes personal informacione të cilat ai i posedon për shkak të funksionit;
- j) të ndikojë në vendimmarrjen e organeve legjislative, gjyqësore ose ekzekutive, duke e shfrytëzuar postin, kjo me qëllim të përfitimit personal, të familjarëve të tij ose të personave të lidhur me të;
- k) të marrë vendime/të ndërmarrë veprime, të cilat në ndonjë mënyrë do t'i vijnë për shtat interesit të tij personal, interesit të familjarëve të tij ose personave të tjerë lidhur me të në dëm të interesit publik;
- l) të marrë vendime/të ndërmarrë veprime të cilat do të ndihmonin ose do ta favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik.

Neni 6

Përdorimi i pronës publike

Funksionari i Partisë ALTERNATIVA nuk guxon të keqpërdorë pasuritë publike që i janë vënë në dispozicion për ushtrimin e funksionit të tij, për qëllime private, politike apo të çdo natyre tjetër që janë në kundërshtim me interesin publik. Ai është i detyruar të përdorë pasuritë publike vetëm për realizimin e detyrave dhe funksioneve të tij publike, duke respektuar ligjin dhe parimet etike të përcaktuara nga Partia ALTERNATIVA

Neni 7

Kufizimet për funksionarin e Partisë ALTERNATIVA

Funksionari i Partisë ALTERNATIVA nuk duhet:

- a) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, por duke i përjashtuar organizatat politike dhe shtetërore në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;
- b) të anëtarësohet ose të mbështetet organizata joqeveritare, objektivat e të cilave bien ndesh me politikat e partisë, duke krijuar kështu një konflikt interesi;
- c) të pranojë ftesa për të vepruar si përkrahës ose t'u ofrojë mbështetje grupeve ose organizatave të varura, tërësisht a pjesërisht, nga fondet publike;

- d) të ushtrojë veprimtari private, që krijojnë të ardhura në formën e personit fizik tregtar;

Neni 8

Dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale

1. Është e ndaluar që një funksionar i Partisë ALTERNATIVA të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen, për shkak të pozicionit të tij, nga një person, fizik ose juridik, privat.
2. Funksionari i Partisë ALTERNATIVA që ka dyshime nëse është në kushtet e ndalimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të kërkojë këshillën e Komisionit të Etikës.
3. Funksionari i Partisë ALTERNATIVA mund të pranojë dhurata nga:
 - a) të afërmit dhe familjarët, përveç rasteve kur ato implikojnë një detyrim;
 - b) vartësit dhe punonjësit e tjerë, për raste të veçanta dhe vetëm kur vlera e tyre është simbolike;
 - c) miqtë, me kusht që dhënia e dhuratës qartësisht të mos lidhet me ofrimin e një favori për dhuruesin.
4. Dhurata, që i jepet funksionarit të Partisë ALTERNATIVA, regjistrohet në një regjistër, i cili mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë ALTERNATIVA.

Neni 9

Rregullat për respektimin e Kodit të Etikës

1. Komunikimet me median për çështje që kanë të bëjnë me qëndrimet politike të Partisë ALTERNATIVA bëhen përmes Zyrës së Marrëdhënieve me Median ose në konsultim me të.
2. Anëtarë i Partisë ALTERNATIVA i zgjedhur në organe drejtuese të Partisë nuk mund të shprehet në emër të Partisë për çështje që kërkojnë një vendimmarje politike pa u konsultuar më parë me strukturat përkatëse vendimmarrëse.
3. Për vendimet e Kryesisë shprehet Kryetari i Partisë, zëdhënësi i Partisë ose një nga anëtarët i ngarkuar nga Kryetari i Partisë.
4. Pjesëmarrësit në debatet publike si përfaqësues të Partisë ALTERNATIVA konsultohen paraprakisht me departamentin përkatës të Partisë, lidhur me qëndrimet e Partisë për çështjet në diskutim.

Neni 10

Komisioni i Etikës

5. Komisioni i Etikës formohet me propozim/urdhëresë të veçantë të Kryetarit të Partisë ALTERNATIVA.
6. Me Komisionin e Etikës udhëheq Kryetari i Partisë ALTERNATIVA.
7. Në urdhëresë përcaktohen përbërja dhe organizimi i Komisionit të Etikës.
8. Mandati dhe funksionimi i tij përcaktohen në urdhëresën e Kryetarit të Partisë ALTERNATIVA.
9. Anëtarë të Komisionit të Etikës mund të jenë anëtarët e dëshmuar për vlera të larta etike dhe profesionale në Partisë ALTERNATIVA dhe në opinionin e gjerë.

Neni 11

Funksioni i Komisionit të Etikës

1. Detyra e Komisionit të Etikës të Partisë ALTERNATIVA është që ta ndjekë zbatimin e këtij Kodi etik.
2. Komisioni i Etikës e vlerëson, për çdo rast veçmas, nëse rasti përbën shkelje të këtij Kodi.

3. Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA ka të drejtë që, në çdo rast, të kërkojë nga Komisioni i Etikës një opinion këshillimor lidhur me sjellje ose veprime të caktuara gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj, nëse ato konsiderohen ose jo në përputhje me normat e Kodit Etik.
4. Komisioni i Etikës ka të drejtë t'i propozojë Kryesisë Qendrore ndryshime në Kodin e Etikës.

Neni 12

Masat disiplinore

1. Funkzionari i Partisë ALTERNATIVA qëndron në detyrë për aq kohë sa e gëzon besimin e Partisë ALTERNATIVA.
2. Komisioni i Etikës i vlerëson standardet e sjelljes që pritet të mbahen nga ana e funksionarit dhe vendos për masat, që do të ndërmerren në rast të thyerjes së këtyre standardeve.
3. Komisioni i Etikës, pasi del në përfundimin se kemi të bëjmë me një thyerje të Kodit Etik të Partisë ALTERNATIVA, ia bën atë me dije funksionarit përkatës këtë vërejtje nëpërmjet një akti me shkrim. Në këtë rast, masat disiplinore që mund të japë Komisioni i Etikës janë:
 - a) vërejtje;
 - b) paralajmërim për shkarkim nga detyra;
 - c) fillimi i procedurave për shkarkim nga detyra.
4. Përveç shkeljeve veçanërisht të rënda, Komisioni i Etikës, përpara fillimit të procedurës së shkarkimit nga detyra, mund ta lejojë funksionarin e Partisë ALTERNATIVA që të japë dorëheqje.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 13

Hyrja në fuqi dhe ndryshimi i Kodit Etik

Kodi i Etikës hyn në fuqi që në ditën e miratimit të tij nga Kryesia Qendrore e Partisë ALTERNATIVA.

Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Etik të Partisë ALTERNATIVA bëhen me propozim të anëtarëve të Kryesisë Qendrore të Partisë ALTERNATIVA dhe miratohen në mbledhje të Kryesisë Qendrore.

Shkup, 20.10.2024

Kryetar i Partisë ALTERNATIVA

Zeqirija Ibrahim

